



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI BASHKIAK
KUKES**

V E N D I M

Nr. 26, Date 08.01.2016

PER

**MIRATIMIN E PAKETES FISKALE TE TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
NE BASHKINE KUKES PER VITIN 2016**

Keshilli i Bashkiak Kukes ne mbledhjen e tij te dates se mesiperme, ne mbeshtetje te ligjit Nr.8652, date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar) nenet 7/2,8/1/III/a/b, 16/1/2/3/4/6, 32/f, 73/1/2, ligjit Nr.9632, date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar) nenet 5,6,9,10,11,20,21/3,33 ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”,(i ndryshuar), ligjit Nr.9975, date 28.07.2008 “Per taksat kombetare” (i ndryshuar), ligjit Nr.9723, “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, (i ndryshuar), ligji Nr.107/2014, date 31.07.2014 “Per Planifikimin e territorit” (i ndryshuar), ligjit Nr.10 465, date 29.09.2011 “Per sherbimin veterinar ne Republiken e Shqiperise” (i ndryshuar), ligjit Nr.8378, date 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise” (i ndryshuar), udhezimin Nr.655/1 date 06.02.2007 “Per percaktimin e uniformitetit te standarteve proceduriale dhe te raportimit te sistemit te kases vendore”, legjislacionit te aplikueshem ne fuqi, bazuar ne Relacionin e hartuar nga grupi i punes per pergatitjen e paketes fiskale per vitin 2016 e vijim, me propozim te Drejtorise Ekonomike dhe Kryetarit te Bashkise, Keshilli Bashkiak Kukes,

V E N D O S I

1.Te miratoje paketen fiskale te taksave dhe tarifave vendore per Bashkine Kukes per vitin 2016, si me poshte:

PAKETA FISKALE E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NE BASHKINE KUKES PER VITIN 2016

A. TAKSAT VENDORE

Taksat vendore trajtohen në mënyrë nominale duke u nisur nga këto elementë:

- a. Llojit i takses
- b. Baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet,
- c. Këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre,
- d. Perjashtimet dhe kushtet lehtësuese,
- e. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

I. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PER BIZNESIN E VOGEL

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i madh se 5.000.000 (pese milion) dhe me i vogël ose i barabartë me 8.000.000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin vogël.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme eshte si me poshte vijon:

- a. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 5 (pesë) për qind.
- b. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë, është 0 (zero) lekë në vit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, vepron si agjent tatimor, i ngarkuar me mbledhjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

II. TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME

Ne Taksat mbi pasurine e paluajtshme perfshihen:

- a. Taksa mbi ndertesen.
- b. Taksa mbi token bujqesore.
- c. Taksa mbi Truallin

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë/juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, ne juridiksionin e Bashkise Kukës, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet, kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Taksat mbi pasurine e paluajtshme llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nese pasuria e taksueshme krijohet, tjetersohet ose zhduket brenda kesaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetem per periudhen e te drejtes se pronesisë.

Siperfaqja ne pronesi e taksapaguesit percaktohet sipas dokumenteve qe vertetojne pronesine, te leshuara nga Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme (ZVRPP).

Nese prona nuk eshte e regjistruar ne regjistrin e pasurive te paluajtshme, per efekt te detyrimit per pagimin e taksës nga taksapaguesi, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, per vertetim pronesisë njeh dokumentat e meposhtem:

- a. Vendimet e Komisionit te Kethimit dhe Kompesimit te Pronave.
- b. Vendimet e Agjensise Kombetare te Privatizimit (AKP).
- c. Dokumentat te tjere te leshuara nga organet perkatese shtetore ne perputhje me legjislacionin perkates.
- d. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i ndërtesës bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së ndërtesës, pranë bashkisë ku ndodhet ndërtesa.

1. TAKSA MBI NDERTESEN

1.1 Baza e taksës mbi ndërtesat eshte siperfaqja e ndertimit ne meter katror e ndertesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nen nivelin e tokës dhe per çdo kat. Detyrimi per taksën llogaritet si shumezim i nivelit te taksës me bazën e taksueshme.

- a. Taksës mbi ndërtesat i nenshtrohen edhe taksapaguesit, te cilet kane, ne perdorim apo ne pronesi, ndërtesa brenda territoreve te miratuara si fshatra turistike.
- b. Siperfaqja e ndërtesës, ne perdorim apo pronesi, percaktohet ne baze te dokumenteve, qe vertetojne perdorimin ose pronesine e saj.
- c. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i ndërtesës bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së ndërtesës, pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.
- d. Taksa mbi ndërtesën llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.

1.2 Kategorite dhe nenkategorite minimale te bazës së taksës dhe nivelet treguese te taksës per çdo kategori minimale te bazës per taksën mbi ndërtesën eshte si vijon, ne Aneksin 1.

Aneksi 1

Kategorite dhe nenkategorite minimale te bazes se takses dhe nivelet treguese te takses per çdo kategori minimale te bazes per taksen mbi ndërtesen per vitin 2016, per Njesine Administrative Kukes

| Nr | Objekti i takses | Niveli i takses 2016 |
|-----------|--|--|
| I | NDERTESE BANIMI | |
| 1. | Ndertesë banimi ndertuar para vitit 1993 | 3.5 leke/m ² |
| 2. | Ndertesë te ndertuara pas vitit 1993 | 4.2 leke/m ² |
| II | NDERTESA TE TJERA | |
| 1. | Ndertesë per tregti dhe sherbime | 150 leke/m ² |
| 2. | Ndertesë qe perdoren per veprimtari prodhuese | 100 leke/m ² |
| 3. | Ndertesë qe perdoren per, kazino, bingo, llotari sportive dhe lojra te tjera fati ne pergjithesi | 220 leke/m ² |
| 4. | Ndertesë ne pronesi apo perdorim, ne territore fshatra turistike | 280 leke/m ² |
| 5. | Te tjera | 40 leke/m ² |
| 6. | a. Personat fizikë, të cilët kanë më shumë se një objekt banimi për shtëpinë ku kanë banimin e zakonshëm, paguajnë taksën e ndërtesës sipas pikes 1/1/2, ndërsa për të gjitha objektet e tjera te banimit, taksa e ndërtesës është sa dyfishi i taksës së ndërtesës, që zbatohet në zonën ku ndodhet kjo ndërtesë. | 12 leke/m ² |
| 7. | Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pashitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambientet e hipotekuara si a. Apartamente banimi do t'i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "Ndërtesa banimi". b. Ndërtesë per biznes do t'i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "Ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime". | 6 leke/m ² 200 leke/m ² |

Shënim: Në të gjitha njësitë administrative të tjera, niveli tregues i taksës për çdo kategori minimale të ndërtesës është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës të kategorisë minimale të ndërtesës në njësinë administrative Kukes, me përjashtim te kompanive minerare dhe hidroenergjitike per te cilat aplikohen nivelet e Aneksit Nr.1.

1.Mënyra e pagesës:

- Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.
- Për të gjitha kategoritë ky detyrim **paguhet me nje këst.**
- Afati i pagesës është data 20 Prill.
- Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

2.Përjashtohen nga pagesa e taksës:

- Pronat e shtetit dhe te njesive te qeverisjes vendore qe perdoren per qellime jofitimpruese,
- Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramaresit me qera të paliberalizuara,
- Ndërtesat që perdoren nga komunitetet fetare.

- d. Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.
- e. Familjet që kanë K/familjarin invalidë të punës, invalidë të luftës;
- f. Familjet e veteraneve të luftës, familjet e “Deshmoreve të Atdheut”
- g. Familjet që kanë në perberjen e tyre të verbër, të sëmurë paraplegjikë/tetraplegjikë etj.

Për të përfituar nga përjashtimi, këto familje duhet të dorëzojnë në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Kukes, dokumentat e mëposhtëm.

- a. Librezën përkatëse;

3.Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

- a. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për të gjitha kategoritë është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Kukes.
- b. Për Familjet do të jetë, Drejtoria e Gjendjes Civile dhe Punonjësi i ZGJC-se, në Njesite Administrative në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Njesite Administrative.

2.TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE.

- a. Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor dhe paguhet brenda vitit fiskal.
- b. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi të taksapaguesit.
- c. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë.
- d. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë strukturave përkatëse të bashkisë.

Aneksi Nr.2

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori:

| Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore | Vlera e taksës në lekë/hektar/vit |
|--|--|
| I | 1,400 |
| II | 1,200 |
| III | 1,100 |
| IV | 1,000 |
| V | 900 |
| VI | 800 |
| VII-X | 700 |

Përjashtime:

Përjashtohen nga taksa e tokës bujqësore, vetëm për normën individuale të tokës, individët:

- a. Invalidët e punës e të luftës, veteranet.
- b. Të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si individë.
- c. Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufutrore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Për të përfituar nga përjashtimi, këto familje duhet të dorëzojnë në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Kukes dokumentacionin përkatës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës;

- a. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për të gjitha kategoritë është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkepunim me Drejtorinë e Planifikimit Urban, sektorin përkatës, pranë Bashkisë Kukes.
- b. Për Njesitë Administrative mbledhja e kësaj takse do të bëhet nga specialisti i ngarkuar në bashkepunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Kukes.
- c. Ngarkohet Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Bashkisë Kukes (ZMMT) për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme.
- d. Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

3.TAKSA MBI TRUALLIN

“Truall”, është një sipërfaqe toke, jo tokë bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumentave ligjore të planifikimit, të miratuar për të ndërtuar mbi të.

1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në meter katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Kategoritë minimale të truallit jepen në Aneksin 3.
2. Niveli i taksës caktohet në lekë për m². Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në Aneksin 3
3. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Aneksi 3

Nivelet treguese të taksës së truallit (Jo hapsirë publike)

| Klasifikimi sipas Bashkive (Kategoria e Katert) Bashkia Kukes | Niveli i taksës në lekë/m²/vit |
|--|--|
| Per qellime banimi per individ | 0,14 Leke /m2 |
| Per qellime Biznes | 12 Leke / m2 |

3.2 Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës ;

- a. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për të gjitha kategoritë është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Kukës.
- b. Per Njesite Administrative mbledhja e kesaj takse do te behet nga Specialisti i njesise administrative i ngarkuar ne bashkepunim me Drejtorine e Taksave dhe Tarifave Vendore prane Bashkise Kukës.

III. TAKSA MBI KALIMIN E TE DREJTES SE PRONESISE PER PASURITE E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesisë per pasurite e paluajtshme vendoset per ndërtesat dhe te gjitha pasurite e paluajtshme ne çastin e kalimit te se drejtes se pronesisë mbi to.

- a. Taksa paguhet nga personi, qe kalon te drejten e pronesisë mbi pasurine e paluajtshme, para kryerjes se regjistrimit, ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi.
- b. Baza e taksës mbi kalimin e se drejtes se pronesisë, per ndërtesat është siperfaqja e ndërtesës, sipas aktit te pronesisë, pronesia e se ciles transferohet. Niveli i taksës caktohet ne leke per meter katror te bazes se taksës.
- c. Detyrimi tatimor llogaritet si shumezim i nivelit te taksës me bazen e tij.
- d. Ne rastet kur pranohet nga vete palet ose kur vertetohet ligjerisht simulim i dhurimit per llogari te nje shitjeje, per shmangie nga taksa, zbatohet taksa sa dyfishi i vleres, pavaresisht nga pergjegjesite e tjera sipas ligjeve ne fuqi.

III.1 Nivelet e taksës se kalimit te pronesisë mbi ndërtesat

Aneksi Nr.4

| Nr. | Kategoria | Njesia e matjes | Taksa |
|-----|--|----------------------|-------|
| 1. | Ndertesë Banimi | Leke/ m ² | 100 |
| 2. | Ndertesë te tjera per tregeti dhe sherbime | Leke/ m ² | 300 |
| 3. | Ndertesë te tjera | Leke/ m ² | 200 |

III.2 Perjashtimi nga taksa e kalimit te pasurise

1. Perjashtohen nga taksa Enti Kombetar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
2. Personat, te cilet jane subjekt i tatimit mbi te ardhurat vetjake, ne mbeshtetje te ligjit Nr.8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar;
3. Subjektet qe dhurojne pasuri te paluajtshme kur perfitues te drejtperdrejte jane:
 - a. Institucionet dhe entet shtetore e publike, qendrore e vendore;
 - b. Bashkesite fetare ose organizatat jofitimprurese, kur dhurimi lidhet me ate pjese te veprimtarise se tyre pa qellim fitimi. Ne keto raste dhuruesi, pasi ka marre vertetimin nga keshilli bashkiak per perjashtimin nga taksa, ben regjistrimin e pasurise se paluajtshme te dhuruar. Ne çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesen qe i takon agjentit te taksave.

III.3 Agjenti Tatimor

Agjenti për vjeljen e takses mbi kalimin e së drejtës së pronësive për pasuritë e paluajtshme, është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

IV. TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIMET E REJA

- a. Baza e takses është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohej të kryhet. Detyrimi për taksen i takon investitorit.
- b. Niveli i takses sipas kategorive dhe nenkategorive për klasifikimin, është si më poshtë:

Aneksi Nr.5

| Nr. | Kategorite dhe Nenkategorite | % e ndikimit ne infrastrukture Viti 2016 |
|-----|--|--|
| 1. | Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja | 2,5 % e vlerës së investimit |
| 2. | Për ndërtimet për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik. | 5 % e çmimit të shitjes për m ² |
| 3. | Leje zhvillimore komplekse për ndërtimin e rrugëve kombëtare, porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, investime në energji etj. | 0,1 % e vlerës së investimit |
| 4. | Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi | 0,5 % e vlerës së investimit |

Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 5 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Baza e takses është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësisë të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Për investimet sipas pikës 3 të Aneksit Nr.5, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 0.1 %, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së demtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

Struktura e ngarkuar për llogaritjen, leshimin e autorizimit dhe ndjekjen e pagesës përkatëse të takses së ndikimit në infrastrukturë është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Teritorit pranë Bashkisë.

V.TAKSA E TABELES

1. Taksa e tabelës aplikohet për subjektet tregtare që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e Bashkisë Kukes, dhe vendosin emrin/emertimin ose çdo të dhënë tjetër, në njësine ku zhvillojnë aktivitetin.
2. Në rastin e më shumë se një tabelë, pavarësisht nga vendndodhja, vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë me qëllime identifikuese ndërsa tabelat e tjera do të konsiderohen si tabela me qëllime reklamuese.
3. Vendosja e tabelës është e detyrueshme për të gjithë subjektet me përjashtim të ambulanteve, tregtareve që ushtrojnë aktivitetin në tregjet e miratuara, mjetet e transportit rrugor.
4. Kategoritë dhe niveli i takses jepet në Aneksin Nr.6:

Aneksin Nr.6

| Nr. | Kategoritë e Takses së Tabelës | Niveli i Takses |
|-----------|--|---|
| 1. | <p>1) Tabelë për qëllime identifikimi:</p> <p>a) Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitetin biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.</p> <p>a.1) Tabelë për qëllime identifikimi mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitetin biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.</p> <p>b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim</p> | <p>0 lekë/vit</p> <p>45 000 lekë/m²</p> <p>120 lekë/vit</p> |
| 2. 2.1 | <p>TABELA PER REKLAME:</p> <p>Tabele për qëllime reklamimi, e levizeshme dhe e palevizeshme</p> <p>Per Bashkitë Qender Qarku</p> <p>a. Tabele e Thjeshte</p> <p>b. Tabele elektronike</p> | <p>22.500 Leke/m² ne Vit</p> <p>45.000 Leke/m² ne vit</p> |
| 3. | <p>Tabele në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj</p> | <p>1,000 leke/m² dite</p> |

Per njesite perberese administrative, niveli i takses se tabelës dhe reklames do te jete sa një e dyta e nivelit tregues përkatës të kategorisë minimale të ndërtesës në njësitë administrative Kukes, me përjashtim te kompanive minerare dhe hidroenergjitike per te cilat aplikohen nivelet e Aneksit Nr.6.

Per te gjitha tabelat dhe reklamat e vendosur ne aksin e autostrades, Tuneli i Kalimashit –Morin, per nivelin e takses do te merren per baze kategorite perkatese te Aneksit Nr.6 (*Bashki Qender Qarku*)

- a. Detyrimi per “Taksën e Tabelës” eshte vjetor, me përjashtim te kategorise 3 ne table
- b. Afati i shlyerjes se detyrimit per kategorine 1, 2 eshte data 20 Prill e vitit fiskal.
- c. Struktura kompetente per dhenien e lejeve per vendosjen te tabelave per kategorine 1,2, dhe 3 eshte Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit te Territorit, prane Bashkise Kukes.
- d. Per kategorine 1,2,3 struktura e ngarkuar per llogaritjen dhe vjeljen e takses eshte Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, prane Bashkise Kukes

Përjashtime

- a. Nga pagesa e taksës së tabelës për **kategorinë I**, përjashtohen subjektet “Ambulant” të cilët nuk kanë një vendndodhje fikse biznesi.

VI. TAKSA E FJETJES NE HOTEL

1. Me “hotel” do te kuptohet çdo veprimtari, qe jep strehim kundrejt pageses dhe perfshin njerin ose disa nga emertimet se bashku: hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtepi pritjeje, turizem familjar dhe çdo objekt tjetër qe perdoret per kete qellim, pavaresisht emertimit qe mban.
2. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel, për person.
 - a. Hotele me 4 - 5 Yje eshte **105 leke/nate fjetje**.
 - b. Bujtine, fjetine, model dhe çdo njesi tjetër akomoduese sipas percaktimeve te ligjit per turizmin, **35 leke /nate fjetje**
3. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
4. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.
5. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

VII.TAKSË E PËRKOHSHME

1. Për linjat ajrore dhe nëntokësore (telefoni, energji elektrike, internet)

Baza e taksës për linjat ajrore dhe nëntokësore është gjatësia lineare për kilometër e linjave ajrore dhe nëntokësore e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi.

Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit duke shumëzuar bazën e taksës (*gjatësinë lineare për kilometër*) me nivelin tregues të saj.

Niveli i kësaj takse për Bashkinë Kukës:

- a. Për linjat nentokësore: 2.000 lekë/km/vit
- b. Për linjat ajrore: 4.000 lekë/km/vit

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së përkohshme për linjat ajrore dhe nentokësore është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Kukës.

Kesaj takse i nënshtrohen tatimpagues me xhiro mbi 8 milion leke të reja.

2. Taksat për shoqëritë e lojërave të fatit dhe basteve sportive

Te gjitha Shoqëritë e Basteve Sportive, të licënuara në këtë fushë, në bazë të ligjit “Për Kazinotë dhe Hipodromet” të cilat ushtrojnë aktivitet sekondar brenda ambienteve të licënuara (Bar-Kafe, Restorant etj), në Njësine Administrative të Bashkisë Kukës, janë të detyruara të paguajnë të gjitha taksat dhe tarifave vendore të parashikuara në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar) dhe në këtë paketë fiskale.

- a. Taksa e pasurisë, e përcaktuar në Aneksin 1, paguhet vetëm nga subjektet që kanë në pronësi/qera objektin ku ushtrojnë aktivitetin (vetëm nga njëri prej subjekteve).
- b. Struktura për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Kukës.

B. TARIFAT

I. TARIFA PER ZENIEN E HAPESIRES PUBLIKE

Në rastin e tarifës për zënie e hapësirës publike për qëllime biznesi:

- a. Tarifa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit;
- b. Baza e tarifës shprehet në metër katror (m^2) sipërfaqe publike të zënë;
- c. Niveli tregues i tarifës jepet në aneksin e meposhtem.
- d. Tarifa për zënie e hapësirës publike nuk aplikohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.

I.1 Niveli Tregues i Tarifës se Zënies se Hapesires Publike

Aneksi 7

leke m^2 /muaj

| Nr. | Kategoria e tarifës | Qyteti Kukës |
|-----|---|-----------------------|
| 1. | Per zenie hapësires publike per tregti (vendosje tavolinash). | 60 leke/ m^2 /muaj |
| 2. | Per zenie hapësires publike per tregti (mallra jashte vendit te tregtimit). | 60 leke/ m^2 /muaj |
| 3. | Per spektakle, panaire te ndryshme, aktivitete kulturore, aktivitete sportive, promocion biznesi, etj. | 100 leke/ m^2 /muaj |
| 4. | Per zenie sipërfaqe me platforma ndertimore, sipërfaqe te rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drure dekorativ etj, sipërfaqe të zëna me antena televizive dhe telefoni, kabina elektrike, shtyllat e transmetimit te energjise elektrike, nënstacione elektrike, fusha sportive, varreza makinash, pishina, çadra fushimi, rulota etj. të ngjashme me to. | 60 leke/ m^2 /muaj |
| 5. | Per sheshe grumbullim, perpunim minerali, jashte zones se miratuar ne Lejen Minerare | 100 leke/ m^2 /muaj |
| 6. | Sheshe grumbullim, perpunim dhe prodhim inertesh, jashte zones se miratuar ne Lejen e Ndertimit | 60 leke/ m^2 /muaj |
| 7. | Per ushtrim aktiviteti, loja elektronike per femije (cirk, kend lojrash) etj. | 100 leke/ m^2 /muaj |

Tarifa e zenes se hapësires publike per njesite perberese administrative aplikohet me 1/2 e nivelit per secilen nga zerat e percaktuar ne Aneksin 7. me perjashtim te kompanive minerare dhe hidroenergjitike per te cilat do te aplikohen nivelet e Aneksit Nr.7

Lehtësirat tatimore

Taksapaguesit përfitojnë kushte lehtësuese kur:

- a. Lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 6-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 5 % të vlerës së detyrimit.
- b. Lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 12-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 10 % të vlerës së detyrimit.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës;

- a. Detyrimi i tarifës përlllogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj. Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Kukes.
- b. Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit Territorit ngarkohet për hartimin e dokumentacionit dhe përcaktimin e sipërfaqeve/hartave të parcelave objekt i kësaj takse si dhe publikimin e tyre.
- c. Drejtoria Juridike ngarkohet për përgatitjen e kontratës-tip për dhenien e siperfaqeve ne zenien e hapësires publike.

II. TARIFA E SHERBIMIT VETERINAR

II.1 Tarifa per Tregun e Bagetive

Aneksi Nr.8

| Nr. | Emertimi | Leke/Per Koke 2016 |
|------------|--|---------------------------|
| 1. | Tregtimi i bagetive te imta per koke | 50 |
| 2. | Per bagetite e trasha, si gjedha e lope | 150 |
| 3. | Per njethundraket per koke | 150 |
| 4. | Per viçat deri ne nje vit | 100 |
| 5. | Per gjitha subjektet qe transportojne bageti te imta dhe viça jashte qytetit per koke | 300 |
| 6. | Per gjitha subjektet qe transportojne njethundrake dhe te trasha jashte qytetit per koke | 500 |

II.2. Tarifa per vulen e veterinerit per mishin e therur, per koke bagetie:

Aneksi Nr.9

| Nr. | Emertimi | Leke/ Per Koke 2016 |
|------------|--|----------------------------|
| 1. | Per bagetite e imta per koke | 100 |
| 2. | Per bagetite e trasha lope e gjedhë per koke | 150 |
| 3. | Per viçat deri ne nje vit per koke | 100 |

II.3 Proçedura e Vjeljes

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës;

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën e shërbimit veterinar është Sektorin e Inspektoriatit Veterinar ne bashkepunim me Drejtorin e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe agjenti i tregut te bagetive.

III. TARIFA E NDRIÇIMIT

Aneksi Nr.10

Tarifa e ndriçimit sipas kategorive te subjekteve:

| Nr | Objekti i tarifes (njesi) | Tarifa (leke) |
|----|---|----------------|
| 1. | Per Familjet Familje me Ndhme Ekonomike | 200 150 |
| 2. | Ambulantet | 200 |
| 3. | Per subjektet fizike te biznesit te vogel | 2,000 |
| 4. | Per mjetet e transportit me perdorim ne sherbim te biznesit personal te personave fizik/juridik | 1.000 |
| 5. | Per institucionet shteterore. Per OJF-te | 5.000 2.000 |
| 6. | Per te gjithë subjektet e biznesit te madh, kompanite e sigurimeve,shoqerite anonime, korporata etj, karburantet,etj. | 5.000 |
| 7. | Per subjektet e ndertimit, seli administrative | 3,000 |
| 8. | Per te gjitha subjektet biznesi i madh qe kryejne disa aktivitete ne nje godine me shume dhoma ose shume kate | 10.000 |

Shenim:

- a. Perjashtohen nga tarifa e ndriçimit familjet e invalideve te luftes dhe te punes, veteranet e luftes si dhe te verberit.
- b. Per subjektet dhe Familjet ne 14 Njesite Administrative trajtohen me 50% te nivelit te tarifes sipas Aneksit Nr.10, me perjashtim te kompanive minerare dhe hidroenergjitike per te cilat aplikohen nivelet e Aneksit Nr.10.

Strukturat e ngarkuar per vjeljen e kesaj tarife:

- a. Kjo tarife per te gjitha subjektet persona juridik/fizik vilet nga Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkise Kukes dhe inspektori perkates ne Njesite Administrative,
- b. Ndersa per familjaret Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ne bashkepunim me Drejtorine e Gjendjes Civile , ZGJC ne Njesite Administrative.

IV. TARIFA E PASTRIMIT.

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave është detyrueshme për të gjithë personat fizike ose juridike, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Kukës.

- Tarifa e pastrimit është e detyrueshme dhe e aplikueshme për pagesë për çdo familje të regjistruar me banim në Bashkinë Kukës.
- Nivelet treguese të tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategoritë dhe nënkategoritë familje, biznes i madh dhe i vogël, person juridik si edhe institucione, janë si më poshtë vijon:

Aneksi Nr.11

Tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave:

| Nr. | Kategorite | Niveli i Tarifës (leke/vit) | |
|--|---|-----------------------------|----------------|
| | | Biznes i Vogël | Biznes i Madh |
| Subjekte të Tregtisë (shitje me pakicë e shumicë) | | | |
| 1. | Subjekte që tregtojnë artikuj ushqimor, artikuj të perzier, bylmet, mish, peshk, fruta-perime etj. | 7,000 | 60.000 |
| 2. | Subjekte që tregtojnë art.industrial, art.kancelarie, pika riparimi radio-televizor dhe telefona mobil, rrobapëpesi, materiale ndertimi etj. | 6,500 | 60.000 |
| 3. | Subjekte që tregtojnë karburant si dhe pikat e furnizimit të gazit të lengshëm, dru zjarri etj. | 6,500 | 60,000 |
| 4. | Bar-Kafe, restorant, fast-food, etj | 7,000 | 60,000 |
| 5. | Shitje produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to | 7,000 | 60,000 |
| 6. | Magazina, dyqane, supermarket që realizojnë shitje me shumicë | 10,000 | 80,000 |
| Subjekte të Prodhimit | | | |
| 7. | Subjekte të prodhimit të artikujve industrial, ushqimor, buke, embelsira, pijeve alkolike apo freskuese, bylmetra, apo prodhimeve bujqësore dhe blegtorale etj. | 7,000 | 60.000 |
| 8. | Subjekte që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e perpunimit të drurit, të prodhimit të mobiljeve, të punimeve të duraluminit, të metalit, të mermerit, të prodhimit të materialeve inerte të ndertimit, prodhimit të granileve etj. | 7,500 | 60,000 |
| 9. | Subjekte që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e perpunimit të mineraleve, nyjeve të prodhimit të inerteve, fabrike asfalto-betoni etj. | 10,000 | 150,000 |

| Subjekte te Sherbimit | | | |
|--|---|---|--|
| 10. | Per hotelet dhe motelet e thjeshta , shtepite si sherbejne si hotele te perkohshme, a) Deri ne 5 dhoma fjetjeje b) Nga 5 deri 10 dhoma fjetjeje c) Mbi 10 dhoma fjetjeje | | 900 leke/dhome 700 leke/dhome 500 leke/dhome |
| 11. | Subjektet qe kryejne sherbime (servis) per automjete, kurse per automjete (autoskolla),agjensi doganore,agjensi transporti,parking automjetesh, lavanderi,pastrim kimik, SHRSF, salla te lojrave dhe kende lojrash per femije si dhe sherbime te ngjashme me to | 6,500 | 60,000 |
| 12. | Subjektet qe ofrojne sherbime bankare, agjensi doganore,kredi-bankare, agjensi sigurimesh | 7,000 | 60,000 |
| 13. | Subjektet qe ofrojne sherbime berber, parukeri, rrobaqepese, kepucar, floktore, orendreqes, etj | 5,000 | 45,000 |
| 14. | Riparim artikuj elektro-shtepiak,radio-televizor,frigorifer,manjetofona,pajisje te ngjashme fonie,agjensi kembimi valuator,,agjensi turizmi,etj. | 5,000 | 40,000 |
| 15. | Subjektet qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne komplekse sportive, palestra,Fitnes, pishine,salla koncerti videoteka etj. | 7,000 | 45.000 |
| Subjekte ndertimi | | | |
| 16. | Per subjektet e Ndertimit, Seli Administrative | 5,000 | 40,000 |
| 16.1 | Njesi ndertimi per çdo kantier ndertimi,objekt banimi,sherbimi, te perbere te ngjashem me to. | 20.000 | 100.000 |
| Institucione shteterore, shoqeri anonime dhe OJF | | | |
| 17. | Per Ente te ndryshme shteterore | - | 120 (lek/m2/vit) |
| 18. | Shoqata, fondacione,organizata (OJF) | 10,000 | 10,000 |
| 19. | Per kompanine energjitike OSSHE | 120 lek/m2/vit per godinen e administrates dhe 10.000 leke per çdo kabine ne territorin e Bashkise Kukes. | |
| Subjekte te prodhimit te energjise dhe nxjerrjes mineraleve | | | |
| 20. | Per te gjithë subjektet prodhuese te energjise elektrike | 150.000 leke per çdo H/C | |
| 21. | Per te gjithë subjektet nxjerrëse dhe perpunuese te mineralit. | 150.000 leke per çdo leje minerare | |

| Profesione te lira | | | |
|------------------------------|--|--------------|----------------------------------|
| 22. | Avokatet,noteret, farmaci,mjeke, mjeke laborant,stomatolog, ekonomist kontabel te miratuar,ekspert kontabel te autorizuar, mesuesit, veterineret, agronom,botues inxhiner, arkitekt, projektuesit etj. | 6,500 | 45.000 |
| Sherbim transporti | | | |
| 23. | Per te gjithë shoferet e transportit te mallrave dhe pasagjereve te cilesuar "Persona fizik apo juridik biznesi i vogel" | 5,000 | 45,000 |
| 24. | Kur ne perdorim kane me shume se nje mjet deri ne dhjete mjete | - | 40.500 +7.200 leke/ mjete |
| Ambulant dhe familjar | | | |
| 25. | Per te gjithë ambulantet etj. | 800 | 800 |
| 26. | Per familjaret | | 700 |
| | Familje ne NE | | 500 |

Lehtesimet:

- a. Per subjektet dhe familjet ne 14 Njesite Administrative trajtohen me 50% te nivelit te tarifës, me perjashtim te kompanive minerare dhe hidroenergjitike per te cilat aplikohen nivelet e Aneksit Nr.11.

Perjashtohen nga tarifa e pastrimit:

- a. Familjaret e invalideve te luftes dhe te punes, veteranet si dhe PAK.

Procedura e vjeljes:

- a. Kjo tarife per te gjitha subjektet persona juridik/fizik vilet nga Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkise Kukes dhe inspektori perkates ne Njesite Administrative.
- b. Ndersa per familjaret Drejtorine e Taksave dhe Tarifave Vendore ne bashkepunim me Drejtorine e Gjendjes Civile , ZGJC ne Njesite Administrative

V.TARIFA E GJELBRIMIT

Aneksi Nr.12

Tarifat e gjelberimit:

| Nr. | Kategorite | Niveli i Tarifes (leke/vit) |
|------------|--|--|
| 1. | Per te gjithë subjektet e biznesit te vogel | 3,000 |
| 2. | Per te gjithë subjektet e biznesit te madh | 5,000 |
| 3. | Ambulantet | 200 |
| 4. | Per Organizatat Jofitimprurese (OJF) | 2,500 |
